



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 51/2012
Prishtinë, më 23.02. 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Ramiz Kelmendi.

Munguan: Berat Buzhala, Visar Ymeri dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha – OSBE, Ukë Gashi – ZRPK, Ardian Kryeziu dhe Gëzim Kolgeci – USAID/BEEP dhe Florije Mehmeti – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.02.2012;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Propozoj që pika e tretë e rendit të ditës *Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike*, të shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse Mimoza Kusari-Lila, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nuk mund të jetë e pranishme në mbledhjen për shkak të agjendës së ngarkuar.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit, që e miratuan rendin i ditës, pasi e hoqën pikën e tretë Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike .

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.02.2012

Procesverbali i mbledhjes së datës 21.02.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike

Kryetari – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës, kemi raportuesen zonj. Sahatqija për raportim lidhur këtë Projektligj.

Teuta Sahatqija – Theksoi se nga mbledhja e kaluar kanë mbetur për t’u diskutuar disa çështje për amendamentet e propozuara nga grupi i punës. Ajo kërkoi nga anëtarët e Komisionit të japin sugjerimet dhe vërejtje e mundshme. Pastaj i prezantoi 42 amendamentet, duke e arsyetuar secilin, një për një.

Ramiz Kelmendi – Kërkoi të hiqet amendamenti numër 2, lidhur me emërtimin e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, sepse ende është në fuqi Ligji për telekomunikacion.

Myzejene Selmani – E përkrahu propozimin e z. Kelmendi. Shtoi se deri sa të jetë në fuqi Ligji për telekomunikacionin, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, duhet të mbetet më këtë emër, sepse nuk kemi bazë ligjore për ta ndryshuar emërtimin.

Komisioni u pajtua më propozimin e z. Kelmendi që të hiqet amendamenti 2.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Miratohet raporti me amendamente i Projektligjit nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike.

4. Të ndryshme

a) Bashkëpunimi më asociacionet që trajtojnë çështjet ekonomike

Ramiz Kelmendi - Propozoj që në të ardhmen, kur të shqyrtohen projektligjet, që kanë të bëjnë me fushën e zhvillimit ekonomik, të ftohën dhe shoqatat e bizneseve për të dhënë sugjerimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me fushën që e kanë aktivitet tyre.

Me këtë propozim u pajtuan dhe anëtarët e Komisionit që në të ardhmen të ftohen asociacionet që trajtojnë çështje ekonomike dhe tregtare. Njëherësh u vendos që ata të ftohen edhe në dëgjime publike ose nëpër konferenca, që do të organizohen nga Komisioni.

b) Diskutimi për çështjen e Distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës-KEK

Myzejene Selmani – Edhe një herë kërkoj që në një mbledhjen e radhës të ftohet z. Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që të na njoftojë lidhur me privatizimin e Distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Kryetari - Tha se për këtë çështje shumë shpejt do të ftohet z. Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që të na njoftojë lidhur me privatizimin e Distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit